



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 82, datë 10.08.2020

**PËR
NJË NDRYSHIM NË VKB NR.68, DATË 15.07.2020 “PËR VIJIMIN E
PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 11 PALLATEVE DHE 1 SHTESE
ANËSORE NË QYTETIN E DURRËSIT, NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE TË
THELLUARA TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË, SI DHE
RINDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË MIRATUAR PËR PRISHJE NË TË NJËJTIN
TRUALL**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të VKB nr. 68, datë 15.07.2020 “Për vijimin e proçedurave të prishjes së detyruar të 11 pallateve dhe 1 shtese anësore në qytetin e durrësit, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, si dhe rindërtimin e objekteve të miratuar për prishje në të njëjtin truall” si më poshtë vijon:
2. Pika 8 bëhet: Objekt ekzistues shtesë e pallatit 5kt i ndodhur në Rrugën “Ahmet Dakli” nr.5, Lagja nr.17, Rajoni nr.5, zona kadastrale 8513, nr.pas 5/461 Durrës.

3. Pika 9 bëhet: Pallati me nr. 1062 i ndodhur në zonën kadastrale nr.8512, (6 kat) i ndodhur në Krugën "26 Nëntori", Lagja nr.7, Rajoni nr.2, Durrës, rindërtimin në truallin ekzsituës.
4. Pika 10 bëhet: Pallatin nr.14, zk nr.8514, me nr.pasurie I /362, Bulevardi "Dyrrah", Durrës, rindërtimin në truallin ekzsituës.
5. Pika 11 bëhet: Pallatin e ndërtuar nga subjekti "KASTRASTI GROUP" shpk, rindërtimin në truallin ekzsituës.
6. Pika 12 bëhet: Pallati 6kt i ndodhur në zonën kadastrale nr.8512 Rruga "Milosao" Nr.1, Lagja nr.9/2, Rajoni nr.2, Durrës, rindërtimin në truallin ekzsituës.
7. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 10.08.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 738 / prot.
6



Durrës, më 11 08 .2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 82 datë 10.08.2020 Për një ndryshim në VKB Nr. 68 datë 15.07.2020 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 11 pallateve dhe 1 shtese anësore në qytetin e Durrësit, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë si dhe rindërtimin e objekteve të miratuar për prishje në të njëjtin truall”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

